Në bazë të nenit 51 dhe nenit 52 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 48 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, në harmoni me nenin 3, 4, 5 dhe 6 paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2026, miraton këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Hajdar Sutaj, kryesues i Komitetit-AAK,
2. Armend Loshaj, anëtar-AAK,
3. Florim Mataj, anëtar-AAK,
4. Elmedina Sadikaj, anëtare- AAK
5. Rrezarta Hadergjonaj, anëtare-ID,
6. Vatan Istrefaj, anëtar-LDK,
7. Ndriçim Çekaj, anëtar-LDK.

II.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tarifat dhe pagesat, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:
-Të emëruarit në pikën I. Të Vendimit,
-MAPL dhe
-Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.I-2
Deçan,dt.29.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K Deçan AS 2658
01 05.02.26

Në bazë të nenit 51 paragrafët 51.1 dhe 51.3 dhe nenit 53 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 48 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, në harmoni me nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2026, miraton këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

I.

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Shkelzen Berisha, përfaqësues i komunitetit Egjiptian
2. Hidajete Guliaj, përfaqësuese e komunitetit Rom,
3. Millanka Popoviç, përfaqësuese e komunitetit Serb,
4. Elda Sharohoviç përfaqësuese e komunitetit Boshnjak,
5. Bashkim Rukaj, përfaqësues i komunitetit Ashkali,
6. Yllka Berisha (AAK),nga Kuvendi,
7. Albese Cacaj (LDK), nga Kuvendi.

Mbledhjen e parë të Komitetit do ta thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Komiteti do ta zgjedhë Kryesuesin e vet nga radhët e veta.

II.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, dhe bën rekomandimin në Kuvendin e Komunës. Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:
-Të emëruarit në pikën I. të Vendimit,
-MAPL dhe
-Arkivi.

01.Nr.I-3
Deçan,dt.29.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 2657
01 05 02 26

Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (d) dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.01.2026, miraton këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2026

I.

Me këtë Vendim miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2026.

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2026.

III.

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura në Planin e punës së Kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2026, gjatë vitit 2026 do të shqyrton edhe çështje të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

IV.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

VI.

Me Vendim pajisen: MAPL, Zyra e Kryesuesit të Kuvendit, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë komunale dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr. I-4
Deçan,dt.29.01.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

K.K Deçan AS 2654
01 05.02.26

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2026

Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (d) dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Deçanit të mbajtur me dt.29.01.2026, miratohet:

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2026

Janar	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit, 2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, 3. Themelimi i Komitetit për Komunitete, 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, 5. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025, 6. Shqyrtimi i raportit financiar për vitin 2025, 7. Shqyrtim i raportit të Planit të Integritetit për vitin 2025.	

	8. Marrja e Vendimit për hartimin e Draft-Rregullores për Plotësimin e kushteve teknike për lokalet afariste në territorin e Komunës së Deçanit dhe Formimi i Komisionit për hartimin e kësaj Draft- Rregullore.	
Shkurt	1. Themelimi i KKSB-së, 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2026, 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. 4. Shqyrtimi I Draft-Rregullores për taksa komunale. 5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Plotësimin e kushteve teknike për lokalet afariste në territorin e Komunës së Deçanit. 6. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (vërshimet), 7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik (Rishqyrtim i Planit të dt.31.07.2025)	

Mars	1. Marrja e vendimit për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2025 në vitin aktual fiskal 2026. 2. Plotësim-Ndryshim I rregullores për menaxhimin e mbeturinave.	
Prill	1. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar - 31 Mars 2026.	
Maj	1.Shqyrtimi i Raportit të KVRL-së,	
Qershor	1. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të punës së Zyrës për Barazi Gjinore. 2. Shqyrtimi i draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029, 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për NPL "Higjiena"; 4. Takimi i I-rë Publik me qytetarë për vitin 2026.	Diskutim publik me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029.
Korrik	1. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës, 2. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar, 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2025 dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit,	

	4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale "Higjiena" Sh.A, 5. Formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe Komisonit të ankesave në procesin e ndarjes së bursave për studentë,	
Gusht	Pushim	
Shtator	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit për vitin 2027 dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme. 2 Njoftim I Drejtorisë për Arsim për përgaditjen e vitit shkollor 2026/2027.	Diskutim public për Projekt –Buxhetin 2027/2029
Tetor	1. Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor financiar.	
Nëntor	1. Caktimi i Normave tatimore për Tatimin në pronë për vitin 2027.	

Dhjetor	Takimi i II-të Publik me qytetarë për vitin 2026. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2027. 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete, 4. Shqyrtimi i raportit të përformancës komunale.	

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura në këtë plan të punës, gjatë vitit 2026 do të shqyrton edhe çështje të tjera, sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

01.Nr.I-4
Deçan,dt.29.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 2655
01 05.02.26

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (c dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 1 dhe pika 9, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.01.2026, miraton këtë:

VENDIM

Për hartimin e Draft-Rregullores për Plotësimin e Kushteve Teknike për Lokalet Afariste në Territorin e Komunës së Deçanit dhe Formimi i Komisionit për hartim të saj

I.

Merret Vendimi për hartimin e Draft-Rregullores për Plotësimin e Kushteve Teknike për Lokalet Afariste në Territorin e Komunës së Deçanit dhe Formimi i Komisionit për hartim të saj, në këtë përbërje:

1.Ibrahim Selmanaj, Ajne Iberhysaj dhe Dyke Llolluni nga Ekzekutivi, Laureta Zejnaj, nga Kuvendi - AAK, Adriatik Alaj nga Kuvendi - AAK, Sylë Balaj nga Kuvendi - LDK dhe Sanije Thaqi nga OJQ

Mbledhjen e parë të Komisionit e thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje komisioni e zgjedhë kryesuesin nga radhët e veta.

II.

Detyrë e Komisionit është që të bëjë hartimin e Draft-Rregullores për Plotësimin e Kushteve Teknike për Lokalet Afariste në Territorin e Komunës së Deçanit dhe t'a harmonizon ate me Statutin e Komunës dhe të gjitha ligjet në fuqi. Pas përgatitjes së tekstit të Draft-Rregullores dhe harmonizimit me dispozitat e Statutit të Komunës dhe të gjitha Ligjeve në fuqi, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me nga një kopje të Vendimit pajisen, të emëruarit në pikën I. dhe Arkivi.

01.Nr.I-8
Deçan,dt.29.01.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 2649
01 05.02.26

Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008) dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kapitulli IV Përzgjedhja e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Neni 14, paragrafi 7, paragrafi 8, nën paragrafi 8.1-Përbërja e Komisionit përzgjedhës, të Rregullore (QRK) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniverzitar, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.01.2026, miraton këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORIT/ESHËS TË SHFMU "LAN SELIMI" LUMBARDH

I.

Me këtë vendim bëhet emërimi i anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit /eshës të SHFMU "Lan Selimi" Lumbardh, në këtë përbërje:

1. Zeqë Malaj nga DKA;
2. Florenta Molliqaj eksperte nga fusha e arsimit;
3. Një anëtar/e nga MASHTI, i cili përcaktohet nga MASHTI, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, e-mail zyrtar nga DKA.

II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit/eshës të SHFMU "Lan Selimi" Lumbardh në Komunën e Deçanit, konform procedurave të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr:19/2024.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.

01.Nr.I-9
Deçan,dt.29.01.2026

K.K Deçan Nr. 2652
01 05.02.26

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", në bazë të nenit 5 paragrafit 5.2 të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, Ndryshohet dhe Plotësohet nga Ligji nr. 08/l-276 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe Ministrat, në mbështetje të neneve 15 dhe 27 paragrafi 3, të Statutit te Komunës se Deçanit, 01-Nr-IX-5, i datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datën.29.01.2026, miratoj këtë:

V E N D I M

1.Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A, me këtë përbërje:

1.Adriatik Alaj, anëtar i emëruar nga Kuvendi Komunal;

2.Kaltrina Ferizi, anëtare e emëruar nga Kuvendi Komunal;

3.Manjolla Shala, anëtare e emëruar nga Kryetari i Komunës.

2.Komisioni Komunal I Aksionarëve veprimet dhe përgjegjësitë e veta I kryen në emër të Komunës, në harmoni me Ligjin për Ndërmarrjet publike dhe Ligjin Nr-06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

3.Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012) dhe më Ligjin Nr-06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

4.Mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive që I janë dhënë me Ligj, Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës dhe i raporton në baza vjetore apo sipas nevojës mbi performancën e kompetencave dhe përgjegjësive si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë te përcaktuar ne nenin 6.2 te ligjit nr.03/l-087 si dhe do të siguron të dhëna të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes Publike Komunale "Higjiena"SH.A.

5. Mandati i anëtareve të Komisionit Komunal të Aksionarëve zgjatë 4 (katër) vite.

6. Kuvendi i Komunës së Deçanit, mundë të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e anëtarëve sa herë që paraqitet nevoja.

7.Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.I-10
Deçan,dt.29.01.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K Deçan AS 2648
01 05.02.26